




PROGRAM ORIENTUES PËR TESTIMIN E INFORMATIZUAR “MËSUES PËR SHQIPËRINË” 2025

LËNDA ART PAMOR





TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES	1
HYRJE	2
QËLLIMI I PROGRAMIT	3
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	4
FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE	4
FUSHA: PROGRAME LËNDORE	6
FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK- UT NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE	7
FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT	10
FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE	10
FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS	11



HYRJE

Programi orientues për testimin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë” të lëndës art pamor është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve që duan të ushtrojnë profesionin e mësuesit në lëndën e artit pamor. Ky program përfaqëson dhe përmbush, njëherazi, kurrikulën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesit dhe përgatitjen për testimin e formimit të përgjithshëm dhe shkencor të kandidatit.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për kandidatët që testohen. Programi përcakton njohuritë dhe aftësitë kryesore sipas fushave të mëposhtme:

- a) Dokumente zyrtare¹, të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore – edukative të mësuesve.
- b) Programe lëndore të artit pamor.
- c) Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie-nxënien e lëndës së artit pamor.
- d) Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- e) Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- f) Përmbajtja shkencore sipas programeve lëndore të artit pamor.

¹ Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.



QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë” të lëndës art pamor është hartuar për të mbështetur dhe për të nxitur zhvillimin profesional të tyre.

Ai ofrohet si një program orientues për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve dhe mësuesve të lëndës së artit pamor në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese. Programi synon:

- rritjen e përgjegjshmërisë së kandidatëve dhe të mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore;
- rritjen e kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor;
- rritjen e aftësive në fushën pedagogjike për mësimdhënie strategjike, për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave për vlerësimin e nxënësve etj.;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkrimore të shqipes;
- demonstrimin konkret të aftësive shkencore dhe të kompetencave të fituara, në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.



PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve të artit pamor është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional të përmendura më sipër. Për secilën fushë, përpos kompetencave profesionale, janë renditur edhe njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojnë mësuesi i lëndës së artit figurativ.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë të testimit, do ta ndihmojnë kandidatin (mësuesin) që të identifikojë nevojat e tij, si dhe çështjet në të cilat duhet të përqendrohet;

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar; Sipas këtij formati, për **secilën fushë prezantohen kompetencat dhe rezultatet** që priten të zotërojnë mësuesi në fushën e njohurive dhe aftësive, **si dhe literatura përkatëse rekomanduese** në funksion të tyre që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE

Kompetenca “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i artit pamor:</i> - zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar, si dhe dispozitat normative të këtij sistemi; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e	- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. - Urdhër Nr. 31 datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”. - Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për

kurrikulës shkollore; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; - demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS-it, në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies; - zbaton etikën profesionale të mësuesit; - respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; - respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; - zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit.	numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar. - Udhëzimi nr. 17, datë 22.07.2024. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë”. -Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”. -Udhëzimi nr. 16, datë 22.07.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”. - Urdhër Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”. - Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.
--	--

FUSHA: PROGRAME LËNDORE

Kompetenca “Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të artit pamor në shkollë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i artit pamor:</i> - zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; - përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; - përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxisin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; - harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me kompetencat e programit; - tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të edukimit figurativ / art pamor); - shpjegon lidhjen program-tekst- nxënës;	- Korniza Kurrikulare, 2014. - Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2014. - Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016. - Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX dhe klasa X - XII.

- përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e kompetencave; - siguron informacion që demonstroi lidhjen e edukimit figurativ/artit pamor me artet e tjera dhe me jetën reale.	
--	--

FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-UT NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE

Kompetenca I	
“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e artit pamor”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i artit pamor:</i> - demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; - përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve; - demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; - identifikon nxënësit me nevojë të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar); - planifikon punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevojë të veçanta; - demonstroi qëndrim pozitiv ndaj lëndës së edukimit figurativ (art pamor); - edukon të nxënësit dashurinë dhe kërshtërinë	- Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017 - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz 2016. - Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), ish IZHA sot (ASCAP), 2016. - <i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>, nëntor 2018. - Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së artit pamor në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018. - Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së artit pamor në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018

ndaj lëndës së edukimit figurativ (art pamor); - motivon nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; - krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; - punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.	
Kompetenca II “Përdorimi i metodave dhe i strategjive efektive në mësimdhënien e artit pamor”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i artit pamor:</i> - përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objektivi të caktuar; - përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve; - planifikon orën mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; - përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve; - përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; - përdor proceset artistike në mësimdhënien – nxënien e edukimit figurativ (art pamor); - demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit;	- Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA, 2016. - Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, IZHA 2018. - Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë. (<i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>), shtator 2019. - Udhëzuesi kurrikular lëndor në Art Pamor në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018. - Udhëzuesi kurrikular lëndor në Art Pamor në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018. - Modele testesh për arsimin parauniversitar (Detyra përmbledhëse të hartuara nga mësuesit), Lënda: Art Pamor.

- shpjegon parimet e hartimit të një detyre përmbledhëse / testi.	
Kompetenca III “Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në art pamor”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i artit pamor:</i> - prezanton materiale artistike duke përdorur teknologji të përshtatshme si: PowerPoint dhe Word; - nxit nxënësit të bëjnë prezantime në edukim figurativ (art pamor), duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; - gjen dhe përdor materiale nga website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien; - përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së edukimit figurativ (art pamor), apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materiale nga Website.	- Urdhër për miratimin e “Standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”, nr. 84 datë 06.05.2021. - Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP 2021

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
“Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i artit pamor:</i> - njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; - sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.	- Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. - Urdhër nr. 46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i artit pamor:</i> - njeh rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; - demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në	- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

Kompetenca “Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së edukimit figurativ (art pamor)”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i artit pamor:</i> - dallon konceptet dhe shprehitë kryesore me të cilat operon lënda e edukimit figurativ (art pamor) në klasat 1-9 dhe 10-12; - përshkruan mënyrën e formimit të koncepteve muzikore në klasat 1-9 dhe 10-12; - përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe shprehive; - dallon ndërvlerësinë e koncepteve figurative/artistike nga njëri - tjetri dhe lidhjen me konceptet e lëndëve të tjera; - përdor situata të ndryshme në edukim figurativ (art pamor), për të zhvilluar natyrshëm konceptet dhe aftësitë e programeve të klasave 1-9 dhe 10-12; - mbledh informacion të saktë e bindës për nxënësit e tij rreth vlerave përdoruese të artit figurativ me artet e tjera dhe në jetën e përditshme.	- Programe dhe tekste të lëndës së artit pamor për mësuesin dhe nxënësin; - Materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat 6-12 në arsimin parauniversitar.

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**



Rruga "Naim Frashëri"
Nr. 37
Tiranë
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

sekretaria@ascap.edu.al

www.ascap.edu.al